QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 2719 Prot.
Datë 9. 3. 2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT ENUAR V MERKO
ZYRA PËRMBARIMORE E.G BAILIFF SERVICE

Adresa: Rr. Ibrahim Rugova, Pallati 64, Hyrja 8, Ap. 1, Tiranë Cel- +355 67 20 27 580, Tel +355 4 22 31 888

Nr. 622/1 .Prot

Tiranë më 12.02.2018

# URDHËR
## PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

**Drejtuar: QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT**

**TIRANË**

Në Tiranë sot më datë 12.02.2018.

Unë **Enuar V MERKO** Përmbarues Gjyqësor Privat me Liçensë Nr.123 pasi studiova dosjen përmbarimore Nr.622 datë 10.01.2018 si dhe në zbatim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 2112 Vendimi, datë 14.12.2017 të Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Tiranë.

**KONSTATOVA**

Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut në cilësinë e kreditorit, ka paraqitur pranë **Zyrës Përmbarimore E.G BAILIFF SERVICE me Përmbarues Gjyqësor Enuar V MERKO**, kërkesën për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv, Akt Administrativ Nr.278, datë 09.08.2017 së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit Nr. 2112 Vendimi, datë 14.12.2017 të Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Tiranë me palë:

- **Kreditor : Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut**
- **Debitor : Shoqëria tregtare "SOLEIL & SEA" Sh.P.K.**
- **Me objekt : Pagim Shume**

Pasi janë zbatuar proçedurat ligjore të njoftimit drejtuar palës debitore për ekzekutim vullnetar të detyrimit, pala debitore nuk ka kryer ekzekutimin vullnetarisht te detyrimit që përmban Titulli Ekzekutiv, Akt Administrativ Nr.278, datë 09.08.2017.

Me vendim të Përmbaruesit Gjyqësor Privat ekzekutimi i Titullit Ekzekutiv, Akt Administrativ Nr.278, datë 09.08.2017 ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Në këto kushte për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv, Akt Administrativ Nr.278, datë 09.08.2017 lëshuar nga **ISHMT** duhet të kryhet bllokimi mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga pala debitore **Shoqëria tregtare "SOLEIL & SEA" Sh.P.K. identifikuar me Nr.NIPT: L21926005F** me qëllim shlyerjen e detyrimit.

Nga sa më sipër si dhe mbështetur në nenin 527 të Kodit Proçedurës Civile dhe në nenet 31 gërma b, 32 gërma c dhe nenin 46 të Ligjit nr.10031 datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat".

## URDHËROJMË

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga pala debitore **Shoqëria tregtare "SOLEIL & SEA" Sh.P.K. identifikuar me Nr.NIPT: L21926005F** për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv, Akt Administrativ Nr.000103, datë 17.08.2017
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.

**PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT**
**ENUAR V MERKO**